



Ardian Biti ka lindur më 4 qershor 1978. Aktualisht mban detyrën e Drejtorit të Monitorimit dhe Jetësimit të Prioriteteve, në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Prej muajit mars 2014, ai ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Komunikimit dhe Monitorimit në Ministrinë e Brendshme, përgjegjës për koordinimin e komunikimit publik të institucionit, marrëdhëniet me median, organizimin e aktiviteteve publike të Ministrisë dhe zyrtarëve të lartë, si dhe përgatitjen e deklaratave për shtyp,

fjalimeve dhe raporteve analitike mbi mbulimin mediatik. Prej vitit 2014, z. Biti ushtron gjithashtu funksionin e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Më herët, gjatë periudhës 2003–2014, ka punuar si gazetar dhe redaktor në Televizionin Kombëtar “Vizion Plus”, duke mbuluar çështje të rëndësishme politike, sociale dhe të sigurisë. Karrierën në gazetari e ka nisur në media të shkruara kombëtare, si gazetat “Republika”, “Panorama” dhe “Dita Jug”, ku ka ushtruar profesionin e gazetarit.

Z. Biti ka përfunduar studimet universitare në vitin 2001 në Fakultetin Histori - Filologji, Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër.

Ai ka ndjekur një sërë trajnimesh dhe programesh ndërkombëtare të specializuara në fushën e komunikimit, marrëdhënieve me publikun dhe sigurinë, përfshirë një workshop të nivelit të lartë të UNESCO-s në vitin 2023 në Gjermani, trajnime të ofruara nga OSBE, Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, si dhe vizita studimore dhe programe profesionale në Slloveni, Belgjikë e Afganistan. Gjithashtu, është trajnuar nga Instituti Shqiptar i Medias, me ekspertë nga media ndërkombëtare, si CNN e BBC.

Z. Biti zotëron aftësi shumë të mira komunikimi dhe organizimi, ka përvojë në menaxhimin e fushatave ndërgjegjësuese dhe në përgatitjen e prezantimeve e fjalimeve për konferenca kombëtare e ndërkombëtare, si dhe flet anglisht, e ka njohuri të gjuhës italiane e greqisht, krahas gjuhës amtare shqipe.